



Msc. Adil Olluri
(Instituti Albanologjik, Prishtinë)

Bio e shkurtër

Adil Olluri (1984) është shkrimtar, studiues dhe kritik letrar. Punon në Degën e Letërsisë të Institutit Albanologjik të Prishtinës. Në krijimtarinë e tij letrare merret kryesisht me prozën artistike, ndërsa në veprimtarinë studimore me letërsinë bashkëkohore shqipe, veçanërisht me postmodernizmin dhe përfaqësimet letrare të diktaturës. Është autor i dy romaneve: Bartësi i shpirtrave të përzënë (Parnas, Prishtinë, 2015; Artini, Prishtinë, 2019; Onufri, Tiranë, 2020) dhe Vdekja e Omerit (Onufri, Tiranë, 2022), si dhe i tri vëllimeve me tregime: Shumë rrugë dhe një rënie (Parnas, Prishtinë, 2011; Artini, Prishtinë, 2017), Kthimi i profetit (Armagedoni, Prishtinë, 2019) dhe Kthimi i babait (Onufri, Tiranë, 2023). Në fushën e studimeve letrare ka botuar monografitë dhe veprat studimore Trilogjia postmoderne (Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011), Romani postmodern shqiptar (AIKD, Prishtinë, 2011; UETpress, Tiranë, 2015), Fytyra e tiranisë: rrëfimi për diktaturën në romane bashkëkohore shqiptare (Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017), Shkrimtari polimorf (Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019) dhe Pikëpjekje letrare (Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2023). Vepra e tij letrare është përkthyer në disa gjuhë të huaja. Vëllimi Shumë rrugë dhe një rënie është përkthyer në gjuhën italiane nga shtëpia botuese “Edizioni Ensemble” dhe është promovuar në Panairin e Librit në Romë. Tregimi Kthimi i babait është përkthyer në gjuhën angleze, çeke, gjermane, italiane, hungareze, maqedonase, sllovene, serbe, bullgare, greke, esperanto dhe rome, duke u bërë një nga tregimet më të përkthyer të letërsisë bashkëkohore shqipe. Olluri është laureat i disa çmimeve letrare kombëtare dhe ndërkombëtare. Në vitin 2017 ka marrë shpërblimin letrar të Asociacionit Ndërkombëtar të Esperantologëve, me seli në Bialystok të Polonisë, ndërsa në vitin 2018 është laureuar me çmimin ndërkombëtar për letërsi “Premio Ostana Internazionale”, në Ostana të Italisë. Për veprën Romani postmodern shqiptar është fitues i Çmimit Kombëtar për veprën më të mirë studimore për vitin 2011, të ndarë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës.

Ka qenë mysafir i Goethe-Institut në Panairin e Librit në Frankfurt (2016).

Titulli: Dosja e Havzi Nelës- Kalimi i kufirit dhe ekzekutimi.

Abstrakt

Në këtë kumtesë do ta trajtoj dosjen e Havzi Nelës, të cilën e kam siguruar me ndihmesën e punonjësve profesionalë të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti i Dosjeve), me seli në Tiranë. Në këtë trajtim do të fokusohem te kalimi i kufirit nga Shqipëria në Kosovë në vitin 1967, që poeti i ndjerë, Havzi Nela kishte bërë për t'i ikur represionit nga ana e regjimit monist në Shqipërinë e asaj kohe, si dhe për trajtimin që i është bërë atij para dhe pas kalimit të kufirit. Po ashtu, do ta trajtoj edhe çështjen e ekzekutimit të tij në qytetin e Kukësit në vitin 1988, në vitet e fundit të diktaturës së proletariatit në shtetin shqiptar. Ekzekutimi e shndërroi atë jo vetëm në një viktimë të radhës së komunizmit, por edhe në një dëshmor të demokracisë dhe përmbykses së regjimit. H. Nela u shndërrua në një simbol që i mbrojti qëndrimet e tij edhe me jetë. Ai u bë i njohur për ne me jetën dhe sakrificën e tij më shumë se sa me veprën e tij letrare, e cila shikuar nga plani artistik dhe stilistik është mesatare. Pra, më shumë do të flas për njeriun, intelektualin dhe dëshmorin e demokracisë se sa për poetin.

Për trajtimin e kalimit të kufirit do të përdor dosjet nr. 9912, nr. 13712 dhe nr. 13532, të cilat i kam siguruar në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Fjalët çelës: Havzi Nela, kalimi, kufiri, ekzekutimi, dosja, regjimi.